



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

URDHËR

Nr. 420, Datë 28/4 /2018

PËR

NGRITJEN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE DHE MARRJEN E VENDIMEVE, PER PËRZGJEDHJEN ME KONKURS TË HAPUR TË SUBJEKTIT KANDIDAT PËR TË OPERUAR NË NJË LINJË TË RREGULLT NDËRQYTETESE UDHËTARËSH

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6 të Ligjit nr.9000, datë 30.12.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 11 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 11, pika 6, të Udhëzimit nr.5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit Vlerësues për shqyrtimin e aplikimeve dhe përzgjedhjen me konkurs të hapur, të subjektit kandidat për të operuar në një linjë të rregullt në transportin ndërqytetës të udhëtarëve brenda vendit, në rastet kur:

- a) aplikohet për licencim për herë të parë;
- b) nuk operohet më nga subjekti i licencuar;
- c) subjekti që ka patur në zotërim licencën për linjën/linjat i është hequr;
- d) subjekti që aplikon për t’u pajisur me licencë nuk plotëson kriteret.

2. Komisionit Vlerësues përbëhet nga:

- Maksim Tashi Kryetar
- Arjan Budo Anëtar
- Flamur Mullisi Anëtar
- Eni Çulli Anëtar
- Nikolin Berxhiku Anëtar.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni përkatës për të aplikuar në konkursin e hapur që do të zhvillohet në MIE, dorëzohen në zyrën e protokollit të MIE-së, ose nëpërmjet shërbimit postar në adresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Sektori përgjegjës për lëshimin e licencave në ministri, pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, i vë në dispozicion Komisionit Vlerësues dokumentacionin e paraqitur nga subjektet e interesuar.

5. Komisioni Vlerësues, pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur për plotësimin e kriterëve të detyrueshme të përcaktuara në legjislacionin përkatës, për subjektet që plotësojnë kriteret e detyrueshme ligjore, bën vlerësimin me pikë, duke marrë në konsideratë edhe:

- vitin e prodhimit të autobuseve;
- pronësinë e autobusëve;
- numrin e vendeve (ndenjësive) të autobusëve;
- përvojën e subjektit në transportin e udhëtarëve.

6. Vlerësimi me pikë i Komisionit Vlerësues, kthehet në vendim, pasi miratohet nga Ministri ose personi i Autorizuar prej tij.

7. Sektori përkatës i licencave, mbi bazën e vendimit, përgatit formatet e licencave dhe certifikatave, sipas modeleve të miratuara në Udhëzimin nr.5627, datë 18.11.2016, i ndryshuar.

8. Komisioni Vlerësues do të publikojë në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të gjithë njoftimet për konkurs të hapur, në bazë të të cilave do të përzgjedhin subjektin kandidat për të operuar në një linjë të rregullt në transportin ndërqytetës të udhëtarëve brenda vendit, si: fillimin e procedurave të konkurimit, datën e konkurimit, shpalljen e fituesit, etj.

9. Urdhëri nr.6004, datë 13.12.2016, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Damian Gjikhuri

